

REPublika e Shqipërisë  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI



VENDIM

Nr. 34 datë 04.05.2020

**Për**  
**Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së**  
**fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Universitetin e Arteve**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të urdhrimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 104, datë 30.4.2020 për "Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19", në mbledhjen e zhvilluar në datë 04 Maj 2020, të Rektoratit të Universitetit të Arteve së bashku me strukturat e tjera të njëjësive kryesore të UART si dhe ato administrative:

VENDOSI

1. Marrjen e masave të nevojshme të të gjitha strukturave drejtuese akademike dhe administrative të UART, për rikthimin në auditore me datë 1 Qershor 2020, të studentëve të vitit të tretë Bachelor dhe studentëve të vitit të dytë Master që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për përsëritjen e lëndëve speciale, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike.
2. Ndryshimin e strukturës vjetore të procesit mësimor për vitin akademik 2019-2020, me Nr. 1041/4 Prot., datë 29.08.2019, sipas kalendarit akademik 2019-2020, më poshtë:
  - a) 1 Qershor-21 Qershor, realizimi i përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të tretë Bachelor dhe për studentët e vitit të dytë të studimeve Master.
  - b) 22 Qershor-30 Qershor, zhvillimi i provimeve të mbartura si dhe java e përgatitjes për provimet përfundimtare, sipas programeve të studimit për secilin fakultet në UART.
  - c) 01 Korrik-07 Gusht sezoni i provimeve, mbrojtja e diplomave, përmbyllja e dokumentacionit për diplomimin e studentëve të vitit të tretë të ciklit të studimeve Bachelor dhe për studentët e vitit të dytë të ciklit të studimeve Master.
  - d) Vijimin e mësimit on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi.
  - e) 31 Gusht-2 Tetor, realizimi i përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve Master.



- f) 21 Shtator-2 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura, si dhe përgatitja për provimet përfundimtare.
- g) 3 Tetor-25 Tetor, sezoni i provimeve.
- h) 26 Tetor-31 Tetor, Sezoni i provimeve të vjeshtës, si dhe përmbyllja e dokumentacionit.
3. Ngarkohen drejtuesit e njësive kryesore si dhe përgjegjësit e njësive bazë të fakulteteve të UART, për hartimin e orarit mësimor me kapacitet të reduktuar si dhe numrin e studentëve me qëllim minimizimin e numrit të studentëve në atelier, studio, klasa, auditorë, laboratorë, etj., për respektimin e distancimit social, deri më datë 11.05.2020.
4. Ngarkohet Administratori i UART, për pastrimin dhe higjienizimin e ambienteve, si dhe marrjen e masave për dezinfektimin e ambienteve, sipas rregullores së miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik.
5. Ngarkohet Administratori i UART, të hartojë dhe të paraqes për miratim rregulloren e brendshme për sjelljen e studentëve në institucion, hyrje-daljet, distancimin social, lëvizjet në institucion dhe higjienizimin periodik të ambienteve deri me datë 11.05.2020.
6. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve për planifikimin e punës me stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe për dokumentimin si dhe pasqyrimin në faqen zyrtare të UART.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
- Administratori i UART;
  - Zv. Rektorët;
  - Drejtuesit e Njësive Kryesore;
  - Drejtuesit e Njësive Bazë;
  - Drejtorët e drejtorive;
  - Të gjitha strukturat e tjera të UART;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORATI

Prof. Kastriot Çausi

